

Ekspozitë në Qendrën Kulturore të Kosovës në Stamboll

Më 10.6.2014, mbështetur nga Ministria e Diasporës, në Qendrën Kulturore të Kosovës në Stamboll u hap ekspozita e grafistes Nexhmije Çerkezi dhe e piktores Valentina Marevci.

Në hapjen e ekspozitës morën pjesë konsulli i përgjithshëm i Republikës së Kosovës në Stamboll, z. Rrahim MORINA, si dhe bashkatdhetarë nga qyteti i Stambollit.

Nëpërmjet kësaj ekspozite, artistet e reja i shpalosën vlerat artistike para artdashëve shqiptarë që jetojnë dhe veprojnë në Turqi.

Ekspozita do të zgjasë deri më 17 qershor.





